

VENDIM
Nr.558, datë 28.5.2009

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE
TË SHETIT TË SHESË MAKINERITË DHE PAJISJET E FABRIKËS SË
USHQIMEVE PËR FËMIJË “BABY FOOD”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9900, datë 10.4.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit të shesë makineritë dhe pajisjet e fabrikës së ushqimeve për fëmijë “BABY FOOD”, sipas vlerësimit të kryer nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha